



Faqe 2
Beogradi e do veriun e Kosovës për vete



Faqe 7
Thaçi: Pas GJND-së, njohje të reja dhe integrim



Faqe 3
Shkarkohet zëvendës-ministri i sapoemëruar Dedaj



Shtojca
KOHA për TV: "Joshja magjike" vjen në KTV

KOHA

Ditore

Numri 4701 • e premte, 16 korrik 2010 • Çmimi € 0.30

Intervistë

Faqe 4-5

Tolaj: Presidenti e kryeministri po më hakmerren



Ish-sekretari i përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë, Ilir Tolaj, konsideron se është arrestuar në shenjë hakmarrjeje për pengesat që po u paraqet qarqeve kriminale të lidhura me krerët e shtetit. Hapjen e procedurës gjyqësore ndaj tij ai e sheh si një tendencë për t'ua mbyllur gojën të gjithë atyre që kanë guxim t'i zbardhin aferat korruptuese

Me diell



Min. 18°C - Maks. 31°C

Nisin edhe zyrtarisht hetimet në Postë-Telekomin e Kosovës

EULEX-i bastis PTK-në, Haxha njëri nga të dyshuarit

Postë-Telekomi i Kosovës është bastisur nga një numër i madh i policëve nën dyshimin për dy raste të korrupsionit. Bëhet fjalë për lidhjen e kontratës në mes të PTK-së dhe "DardaPhone" dhe për dërgimin e mbi 40 punëtorëve të PTK-së për trajnim në një universitet në të cilin punon kryeshefi Shyqyri Haxha. Ai është njëri nga të dyshuarit për korrupsion

KOHA

Ditore

*VEHBI KAJTAZI
E KASTRIOT JAJAJ*

PRISHTINË, 15 KORRIK – Rreth 50 policë të njësisë speciale të EULEX-it kanë "trokitur" të enjten në mëngjes në derën e Postës dhe Telekomit të Kosovës, nga ku kanë dalë pas shtatë orësh të ngarkuar me materiale të shumta lidhur me dyshimet për korrupsion e krim të organizuar. Shumë policë të tjerë kanë "vizituar" edhe shtëpinë e kryeshefit ekzekutiv të PTK-së, Shyqyri Haxha, dhe të njërit prej partnerëve, kompanisë "Devolli". Hetuesit policorë kanë bastisur në tetë lokacione në Prishtinë dhe Pejë për të marrë informacione rreth nënshkrimit të një kontrate për bartjen e licencës për telekomunikim në rrjetin mobil virtual, e nënshkruar në vitin 2007-2008, mes kompanisë "DardaPhone" dhe PTK-së.

Cak i bastisjeve të EULEX-it kanë qenë zyrat e "DardaPhone", "Devolli Group", "Z-Mobile", baneja e kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së, Shyqyri Haxha, si dhe shtëpia e pronarit të kompanisë "Devolli", Shkëlqim Devolli.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nga kryeshefi i PTK-së, sipas burimeve në prokurori, e bën të dyshuar për korrupsion Shyqyri Haxhën. Po sipas burimeve, objekt hetimi është edhe dërgimi i mbi 40 punë-



torëve të PTK-së për trajnim në një universitet në të cilin Haxha është mësimsdhënës.

Hetuesit e EULEX-it në bashkëpunim edhe me hetues kosovarë në kuadër të "Task Forces" kundër korrupsionit kanë nxjerrë dhjetëra punëtorë nga

PTK-ja në lokacionet ku janë kryer bastisjet e shumta. Burime brenda PTK-së kanë bërë me dije se hetuesit kanë bastisur për më shumë se shtatë orë në zyrën e Haxhës, në zyrat e arkivit, zyrën lidhore dhe në Prokurimin e postës. Policët që kishin zbarkuar me 12

automjete të EULEX-it tek pas katër orësh të bastisjeve kanë filluar të nxjerrin materiale nga PTK-ja. Ata kanë marrë me vete edhe shumë kompjuterë, kontrata e materiale të tjera që lidhen me dyshimet. Bastisjen e këtyre lokacioneve e ka confirmuar EULEX-i

dhe zyrtarët e kompanive nën hetim.

"Në sfond të këtyre hetimeve është bartja e një licence për telekomunikim të një ORRMV (Operatori në Rrjetin Mobil Virtual) në vitet 2007 dhe 2008 ndërmjet "Dardafon" Sh.p.k; "Dardafon". NET. Sh.p.k dhe PTK-së, e cila dyshohet se është bërë në mënyrë të kundërligjshme", ka confirmuar EULEX-i nëpërmjet një komunikate të lëshuar dy orë pas nisjes së bastisjeve. Sipas kësaj komunikate, këto bastisje janë të ndër-lidhura edhe me një hetim tjetër të dytë për korrupsion, por nuk saktësohet për çfarë rasti.

Bastisje e njëjtë ka vazhduar edhe në zyrat e "Z-Mobile", në fabrikën e qumështit "Vita" dhe në objektet e tjera biznesore të kësaj kompanie. Aksionin e policisë e ka confirmuar edhe kompania "DEVOLLI Group", nëpërmjet një komunikate, në kuadër të së cilës funksionon edhe operatori "Z Mobile". Kjo kompani këtë bastisje e ka quajtur si "vizitë" të paparalajmëruar. "Kompania "DEVOLLI Group", me rastin e bastisjes së paparalajmëruar të policisë së EULEX-it, u ka mundësuar atyre qasje të lirë për kontroll, duke iu përgjigjur kërkesave të parashtruara prej tyre.

(vijon në faqen e tretë)

Arbëri

Faqe 2

Diskutohen me ambasadorët e Quintit hapat pas GJND-së

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka qenë nikoqir i një takimi me ambasadorët e vendeve të Quintit, të enjten, për të diskutuar hapat që duhet t'i ndërmarrë Kosova pas daljes së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me opinion për ligjshmërinë e pavarësisë. Takimin e presidentit me ambasadorët e vendeve të Quintit, në të cilin kanë marrë pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi...

Arbëri

Faqe 13

UP-ja hap sot dyert për regjistrimin e studentëve

Prej sot (e premte) të gjithë maturantët mund të konkurrojnë në Universitetin Publik të Prishtinës, si dhe në fakultetet e kolegjet private të licencuara nga Agjencia për Akreditimin e institucioneve arsimore private. Vendimin për shpalljen e konkursit për vitin akademik 2010/2011 e ka marrë Senati i UP-së në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur të enjten. Me këtë rast është bërë me dije se këtë vit në UP...

Ekonomi

Faqe 8

Rekomandimet e Brukselit nuk e ndryshojnë projektin

Projekti "Kosova e Re" nuk do të ndryshojë si rrjedhojë e rekomandimeve të Komisionit Evropian për rregullimin e tregut të brendshëm me rastin e ndërtimit të këtij termocentrali, ka pohuar ministrja e Energjisë dhe e Minierave, Justina Pula. Pas kthimit nga Brukseli ku temë kryesore ka qenë rregullimi i tregut me rastin e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re" në pajtim me rregullat e BE-së, Pula ka thënë...

Botë

Faqe 21

Irani tronditet nga sulme vetvrasëse - 20 të vrarë

Dy sulme vetvrasëse në një xhami shiite në juglindjen e Iranit me shumicë sunite kanë lënë të paktën 20 të vrarë, përfshirë besimtarë dhe pjesëtarë të Gardës Revolucionare, kanë raportuar mediat shtetërore. Sulmet kanë ndodhur në kohën kur njerëz të shumtë ishin mbledhur për ta kremtuar ditëlindjen e imamit Hussein, nipit të profetit Muhamed, një ditë kjo po ashtu që është ndarë për të nderuar Gardën Revolucionare...